



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E SHËNDETËSISË DHE MIRËQENIES SOCIALE
INSTITUTI I SHËNDETIT PUBLIK
NJËSIA BAZË (DEPARTAMENTI) I EPIDEMIOLOGJISË DHE KONTROLLIT TË
SËMUNDJEVE INFEKTIVE

BULETINI JAVOR I SËMUNDSHMËRISË INFEKTIVE - ALERT
JAVA 21
18 maj – 24 maj 2026

Për këtë javë, kanë raportuar 36 Njësi Vendore të Kujdesit Shëndetësor (NJVKSH) ose 100% (=36/36) e tyre.

Tabela 1. Plotësimi i formularit ALERT sipas çdo NJVKSH-je

Perqindja e plotesueshmerise				
Rajoni	Qarku	Njvksh	Nr. Qendrave	%
TIRANË	Tiranë	Tiranë	35 / 35	100%
		Kavajë	10 / 10	100%
	Durrës	Durrës	20 / 20	100%
		Krujë	6 / 6	100%
	Dibër	Dibër	16 / 16	100%
		Mat	13 / 13	100%
		Bulqizë	9 / 9	100%
ELBASAN	Elbasan	Elbasan	28 / 28	100%
		Librazhd	11 / 12	92%
		Gramsh	8 / 8	100%
		Peqin	7 / 7	100%
	Korçë	Korçë	18 / 18	100%
		Pogradec	9 / 9	100%
		Devoll	6 / 6	100%
		Kolonjë	4 / 4	100%
	Berat	Berat	15 / 15	100%
		Kuçovë	4 / 4	100%
		Skrapar	7 / 7	100%
SHKODËR	Shkodër	Shkodër	19 / 19	100%
		M. Madhe	6 / 6	100%

	Kukës	Pukë	9 / 11	82%
		Kukës	14 / 14	100%
		Has	5 / 5	100%
		Tropojë	9 / 9	100%
	Lezhë	Lezhë	10 / 10	100%
		Kurbin	5 / 5	100%
		Mirditë	4 / 6	67%
VLORE	Vlorë	Vlorë	21 / 21	100%
		Sarandë	10 / 10	100%
		Delvinë	5 / 5	100%
	Fier	Fier	20 / 20	100%
		Lushnjë	18 / 18	100%
		Mallakastër	9 / 9	100%
	Gjirokastrë	Gjirokastrë	21 / 21	100%
		Përmet	8 / 8	100%
		Tepelenë	7 / 7	100%
		TOTAL	426 / 431	99%

Tabela 2. Numri Total i Rasteve të Sindromave të Survejancës “Alert” në Javën 21

	JAVA 21
Diarre pa gjak	1404
Diarre me gjak	0
Inf. Resp. të sipërme	7594
Inf. Resp. të poshtme	3021
Rash me temperaturë	42
Verdhëza	0
Ethe e zgjatur e pashpjeguar (> 3 javë)	0
Anomali kongenitale	0
Konjuktivit akut te neonatët	0
Numri i Njësive Raportuese	426
% e Njësive Raportuese	99% (426/431)

Rash me temperaturë

Nga hetimi epidemiologjik dhe konsultat me mjekët e familjes, mjekun infeksionist dhe atë epidemiolog, rastet e mëposhtme nuk janë të dyshuar për fruth, rubeolë apo linë e majmunit, por për variçelë:

Tiranë – 12 raste



Fier– 13 raste

Vlore – 9 raste



Diber – 1 rast

Mat– 1 rast

Sarandë – 6 raste


Grafiku 1. Prirja në kohë e Infeksioneve Respiratore të Sipërme dhe të Poshtme sipas javëve**Grafiku 2. Shpërndarja e Infeksioneve Respiratore të Sipërme dhe të Poshtme sipas grup-moshave**

Prirja në kohë e Infeksioneve Respiratore të Sipërme dhe të Poshtme paraqet rritje në javën 21 të vitit 2026 krahasuar me javën paraardhëse, java 20.

Grafiku 3. Trendi në kohë i Diarreve pa gjak sipas javëve**Grafiku 4. Shpërndarja e Diarreve pa gjak sipas grup-moshave**


Prirja në kohë e “Diarreve pa gjak” paraqet ulje në javën 21 të vitit 2026 krahasuar me javën paraardhëse, java 20.

Grafiku 5. Prirja e “Infeksioneve Respiratore të Sipërme dhe të Poshtme” në javët 05 – 21 të sezonit 2024-2025 dhe sezonit 2025-2026. Numri i rasteve.




Në javën 21 të vitit 2026 vërehet një rritje e numrit të Infeksioneve Respiratore të Sipërme dhe të Poshtme.

Grafiku 6. Frekuenca e “Infeksioneve Respiratore të Sipërme dhe të Poshtme” sipas grupmoshës. Incidenca (raste/10.000)




Grafiku 7. Frekuenca e hasjes së “Infeksioneve Respiratore të Sipërme dhe të Poshtme” sipas NJVKSH-ve në javën 20/2026 dhe 21/ 2026. Incidenca (raste/10.000).




Vërehet një rritje e lehtë e infeksioneve respiratore në disa NJVKSH, ndërsa aktiviteti i gripit mbetet në nivel të ulët sezonal.

Grafiku 8. Prirja e “Diarreave pa Gjak” në javët 05-21 të sezonit 2024-2025 dhe sezonit 2025-2026. Numri i rasteve.



Në javën 21 vërehet prirje në ulje e numrit të rasteve “Diarre pa gjak”, këtë vit vërehet një numër më i madh i këtyre infeksioneve, krahasuar me një vit më parë.

Grafiku 9. Frekuenca e hasjes së “Diarreve pa gjak” sipas NJVKSH-ve në javën 20-21/2026 Incidenca (raste/10.000).



Vërehet një rritje e rasteve me diarre, veçanërisht në NJVKSH Tropoje, Has dhe Kukës ku situata po monitorohet në mënyrë të vazhdueshme.

Ngjarje ndërkombëtare

Shpërthim i sëmundjes nga Hantavirusi në një anije turistike – Atlantiku Jugor – 2026

- Deri më 22 maj 2026, janë raportuar gjithsej 11 raste të sëmundjes nga virusi Andes (ANDV), përfshirë nëntë raste të konfirmuara dhe dy raste të mundshme. Që nga përditësimi i mëparshëm nuk janë raportuar raste apo vdekje të reja.
- Zbritja dhe evakuimi i pasagjerëve dhe ekuipazhit nga anija turistike M/V Hondius u krye në Tenerife, Ishujt Kanarie, gjatë datave 10–11 maj dhe në Rotterdam, Holandë, më 18 maj. Anija ndodhet e ankoruar në Rotterdam që prej datës 18 maj, ku po kryhen procedurat e dezinfektimit.
- Analiza paraprake e sekuencimit gjenomik nga disa prej rasteve pozitive konfirmoi një nivel të lartë ngjashmërie gjenetike midis izolimeve virale, çka sugjeron mundësisht një ngjarje fillestare transmetimi nga kafsha tek njeriu (spillover zoonotik), e ndjekur nga transmetim nga njeriu tek njeriu.
- Rreziku për popullatën e përgjithshme në Shqipëri dhe Europë nga përhapja e virusit Andes lidhur me këtë shpërthim në anijen turistike mbetet shumë i ulët.

Gripi i shpendëve A(H9N2) – Monitorimi i rasteve tek njerëzit

- Më 15 maj 2026, u raportua një rast i ri human i infeksionit nga virusi i gripit të shpendëve A(H9N2) në Kinë, me fillim të simptomave në prill 2026.
- Pacienti është një fëmijë nga Provinca Sichuan.
- Pacienti kishte pasur ekspozim në një treg të shpendëve të gjallë.
- Nuk janë identifikuar raste shtesë ndër kontaktet e afërta të pacientit.
- Në total, që nga viti rritje98, janë raportuar globalisht 203 raste njerëzore të gripit të shpendëve A(H9N2), përfshirë dy vdekje (shkalla e fatalitetit/CFR 0.98%), nga 11 vende.
- Rreziku për shëndetin e njeriut në vendet e BE/EEA aktualisht konsiderohet shumë i ulët.

Sëmundja nga virusi Chikungunya – Guajana Franceze, Francë – 2026

- Qarkullimi i virusit Chikungunya vazhdon në Guajanën Franceze, ku janë raportuar 249 raste që nga janari 2026 deri më 7 maj.
- Tetëdhjetë për qind e këtyre rasteve janë konfirmuar në sektorin Littoral ouest. Më 23 prill, ky sektor u deklarua në fazën “epidemike” të shpërthimit.
- Sektori Île de Cayenne aktualisht ndodhet në fazën e “grupeve të shpërthimeve” (outbreak clusters).
- Probabiliteti aktual i infektimit nga virusi Chikungunya për udhëtarët drejt Guajanës Franceze vlerësohet i ulët; gjithashtu, probabiliteti i transmetimit të mëtejshëm në Europën kontinentale pas hyrjes së një udhëtari viremi konsiderohet i ulët.

• Udhëtarëve u rekomandohet të zbatojnë masa të shtuara për mbrojtjen nga pickimet e mushkonjave. Vaksinimi mund të merret në konsideratë bazuar në rekomandimet kombëtare.

Fruthi –Monitorim i shpërthimeve në Europë – Raport mujor

• Në mars 2026, 30 vende të BE/EEA raportuan të dhëna për fruthin. 12 vende raportuan gjithsej 172 raste, ndërsa 18 vende nuk raportuan asnjë rast.

• Gjatë periudhës 12-mujore, janë raportuar 5 vdekje të atribuuara fruthit pranë ECDC nga Franca (3), Holanda (1) dhe Rumania (1).

• Në përgjithësi, numri i rasteve është rritur krahasuar me muajin e mëparshëm.

• Survejanca shtesë e inteligjencës epidemike më 20 maj 2026 ka identifikuar shpërthime në Bullgari, Francë dhe Portugali. Gjithashtu janë raportuar raste sporadike dhe klastera në disa vende të tjera të BE/EEA. Përditësime janë dhënë edhe për disa vende dhe rajone jashtë BE/EEA.

Përmbledhje e shkurtuar mbi shpërthimin e Ebola-s (BDBV) – 25 Maj 2026

Më 15 maj 2026, Africa CDC raportoi një shpërthim të sëmundjes Ebola në Republikën Demokratike të Kongos (DRC), i shkaktuar nga virusi Ebola Bundibugyo (BDBV). OBSH e shpalli ngjarjen Emergjencë të Shëndetit Publik me Rëndësi Ndërkombëtare më 17 maj 2026.

Deri më 25 maj 2026, shpërthimi ka prekur Republikën Demokratike të Kongos dhe Uganden. Në DRC janë raportuar mbi 900 raste të dyshuara dhe 101 raste të konfirmuara, ndërsa në Ugandë shtatë raste të konfirmuara, përfshirë një vdekje. Rastet janë raportuar edhe në qytetet Bunia dhe Goma.

Transmetimi i virusit ndodh përmes kontaktit të drejtpërdrejtë me gjakun ose lëngjet trupore të personave apo kafshëve të infektuara. Aktualisht nuk ka vaksinë apo trajtim specifik të licencuar për BDBV.

Sipas vlerësimit të OBSH dhe ECDC, rreziku për popullatën në Shqipëri dhe Europë mbetet shumë i ulët. Rastet e importuara konsiderohen të rralla dhe mundësia e transmetimit të qëndrueshëm në Europë është shumë e ulët.

Masat e marra në Shqipëri

- Rritje e vigjilencës në Aeroporti Ndërkombëtar Nënë Tereza dhe në pikat kufitare.
- Informim dhe trajnim i epidemiologëve, infektologëve dhe laboratorëve.
- Rishikim i protokolleve të izolimit, diagnostikimit dhe kontrollit të infeksionit.
- Vlerësim i pajisjeve mbrojtëse personale në aeroport, portin e Durrësit dhe shërbimin infektiv.
- Informim për udhëtarët që kthehen nga zonat e prekura që të vetëizolohen dhe të kërkojnë menjëherë kujdes mjekësor nëse shfaqin simptoma brenda 21 ditëve.

ISHP po monitoron situatën në bashkëpunim me OBSH dhe ECDC, duke përditësuar vazhdimisht vlerësimin e rrezikut dhe masat e gatishmërisë.